



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPËSTINA VUÇITRN

02 Nr. / Br 707/23

Nr. i fq. / Br. st \_\_\_\_\_

Data: / Datum 07.06.2023

VUSHTRRI - VUÇITRN



REPUBLICA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI  
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 8 pika 2, 3 dhe 4 të Rregullores së MF – NR. 04/2017 mbi Kriteret Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve si dhe nenin 43 paragrafi 14 dhe 44 paragrafi 1 të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr,


**V E N D I M**  
**PËR THEMELIM TË KOMISIONIT VLERËSUES PËR NDARJE TË SUBVENCIONEVE PËR OJQ-të E KOMUNËS**

1. Themelohet Komisioni Vlerësues për vlerësim të aplikacioneve sipas thirrjes publike të datës 02.05.2023 të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, për ndarje të subvencioneve në fushën e shëndetësisë dhe përkujdesjes sociale, për OJQ-të e Komunës së Vushtrrisë, për vitin 2023.
2. Komisioni Vlerësues ka këtë përbërje:
  - 2.1 **Naim Ferizi**, - kryesues
  - 2.2 **Besim Demiraj**, - anëtar
  - 2.3 **Fitore Hyseni Zogaj**, – anëtare
  - 2.4 **Imer Uka**, – anëtare
  - 2.5 **Rinor Beqiri**, - anëtar
  - 2.6 **Besarta Muzaqi Feka** - anëtare rezervë
3. Anëtar i rezervë do të zëvendësoj në rast nevojë anëtarin e Komisionit Vlerësues i cili ka konflikt interesi me ndonjërin prej aplikuesve për subvencion.
4. Komisioni Vlerësues me rastin e vlerësimit të aplikacioneve dhe përzgjedhjes së përfutësve do të zbatoj procedurat e përzgjedhjes konform dispozitave të Rregullores së MF – NR. 04/2017 mbi Kriteret Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.
5. Komisioni Vlerësues në mbledhjen e tij të parë miraton rregullat e punës përmes të cilave do të udhëhiqet puna në komision.
6. Komisioni Vlerësues ka mandat deri në fund të vitit 2023.
7. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Vendimi i iu dërgohet:

- Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,
- Anëtarëve të Komisionit Vlerësues
- Arkivit të Sekretarisë.





REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI  
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 43 paragrafi 14 dhe 44 paragrafi 1 të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

### V E N D I M PËR FORMIM TË KOMISIONIT

1. Formohet komisioni për përgatitje të Draft – Programit tre vjeçare të banimit për Komunën e Vushtrrisë, në këtë përbërje:
  - 1.1 Naim Ferizi, Drejtorja për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale
  - 1.2 Naime Krasniqi, Qendra për Punë sociale
  - 1.3 Ilirijana Azemi, Drejtorja për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
  - 1.4 Ramiz Maliqi, Drejtorja për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
  - 1.5 Besim Demiraj, Drejtorja për Buxhet dhe Financa
2. Komisioni në përbërje të cekur si në pikën paraprake të këtij vendimi do të përgatis Draft – Programin tre vjeçar të banimit për Komunën e Vushtrrisë për periudhën 2024-2026. Komisioni, pas përfundimit të punës, draftin e programit do ta procedoj për shqyrtim dhe aprovim në mbledhje të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendin e Komunës.
3. Komisioni do të filloj me punë menjëherë dhe përfundoj përgatitjen e draft programit brenda afatit optimal.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Vendimi i dërgohet:

- Anëtarëve të Komisionit
- Arkivit të Sekretarisë.



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPËSTINA VUÇITRN

02 Nr. / Br 710/23

Nr. i fq. / Br. st \_\_\_\_\_

Data: / Datum 07.06.2023

VUSHTRRI - VUÇITRN



REPUBLICA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 43 paragrafi 14 dhe 44 paragrafi 1 të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

**V E N D I M**  
**PËR FORMIM TË KOMISIONIT**

1. Formohet komisioni për verifikim të shfrytëzimit të banesave/shtëpive të banimit social të cilat janë në pronësi të komunës.
2. Në përbërje të komisionit caktohen:
  - 2.1 Naim Ferizi, Drejtorja për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale
  - 2.2 Abaz Shyti, Drejtorja për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale
  - 2.3 Isak Uka, Qendra për Punë Sociale
3. Komisioni në përbërje të cekur si në pikën paraprake të këtij vendimi do të bëjë verifikimin e të gjitha banesave/shtëpive të banimit social në territorin e Komunës, të bëjë identifikimin e titullarëve të cilëve komuna ua ka dhënë ato në shfrytëzim. Komisioni gjithashtu do të verifikojë nëse ato banesa janë duke u shfrytëzuar sipas kontratave për dhënie në shfrytëzim.
4. Lidhur me gjendjen e konstatuar komisioni do të hartoj raport me shkrim për kryetarin dhe kuvendin e komunës. Në raport komisioni do të jap rekomandime për zgjedhje të problemeve eventuale rreth shfrytëzimit të atyre banesave.
5. Komisioni do të fillojë me punë menjëherë.
6. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.




Ferit Idrizi

Kryetar i Komunës

Vendimi i dërgohet:

- Anëtarëve të Komisionit
- Arkivit të Sekretarisë.



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Në pajtim me nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040, nenin 44 pika 3 të Ligjit për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera nr. 04/L-027, nenin 44 paragr. 1 të Statutit të komunës, pas gjendjes së krijuar në terren me rastin e vërshimeve nga reshjet e shiut në orët e vona të pasdites së datës 14.06.2023, Kryetari i Komunës merr këtë:

VENDIM  
PËR FORMIM TË SHTABIT PËR GATISHMËRI EMERGJENTE NË KOMUNËN E  
VUSHTRRISE

1. Me qëllim të ndërmarrjes së masave për tejkalim të gjendjes së krijuar në terren nga reshjet e shiut, formohet Shtabi për Gatishmëri Emergjente në këtë përbërje:
  1. **Ferit Idrizi**, Kryetar i Komunës, kryesues i shtabit
  2. **Shpëtim Zhegrova**, zv.kryesues
  3. **Maliq Ferizi**, Drejtor i DMSH-së, anëtar,
  4. **Bajram Beqiri**, zyrtar në DMSH, anëtar,
  5. **Benjamin Shala**, Drejtor i DSHP, anëtar
  6. **Nexhmedin Rashica**, Drejtor i DSHS, anëtar,
  7. **Ergin Sunguri**, Drejtor i EBPZHR, anëtar
  8. **Dardan Abazi**, Drejtor i Arsimit, anëtar
  9. **Reshat Kovaçi**, Komandant i Stacionit Policor, anëtar
  10. **Fadil Hyseni**, Shef i Nësisë së Zjarrfikësve
  11. **Fadil Bahtiri**, Kryeshef i NPL "Përpatrimi", anëtar
  12. **Përfaqësuesi i Kryqit të Kuq në Vushtrri**, anëtar
  13. **Mirjeta Duraku**, Zyrtare për informim, anëtare
  14. **Përfaqësuesi i KEDS-it**, anëtar
  15. **Shefqet Maloku** Menaxheri i KRU Njësia në Vushtrri
  16. **Përfaqësuesi i Shoqatës së Peshkatarëve në Vushtrri**, anëtar
1. Bazuar në Planin Komunal për Mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera Shtabi emergjent duhet të përcjellë 24 orë situatën në terren, dhe koordinoj punët dhe veprimet e tij, të bashkëpunoj me Policinë e Kosovës, KEDS-in, Ujësjetësin Rajonal "Mitrovica", Njësia në Vushtrri dhe akter tjerë relevant të ndërlidhur në këto situata emergjente, me qëllim të mbrojtjes së popullatës dhe të mirave materiale nga vërshimet.

2. Drejtorët përkatës të drejtorive komunale duhet të ofrojnë mbështetjen e duhur për Qendrën apo ekipet në terren gjatë gjithë kohës sa zgjat gjendja e emergjente si dhe të i kenë në dispozicion në çdo moment të hapur telefonat mobil.
3. Shtabi Emergjent do të përcjell situatën në terren dhe sipas nevojës informoj me kohë qytetarët lidhur me gjendjen në terren për të përballuar sa më lehtë dhe pa pasoja situatat emergjente.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë.



**Ferit Idrizi**

*Ferit Idrizi*  
Kryetar i Komunës

Vendimi iu dërgohet:

- Anëtarëve të shtabit emergjent
- Arkivit të sekretarisë

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRISË-OPËSTINA VUÇITRN

02 Nr. / Br 739/23

Nr. i fq. / Br. st \_\_\_\_\_

Data: / Datum 14.06.2023

VUSHTRRI - VUÇITRN



REPUBLICA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari



Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 8 paragrafi 2, nënparagrafi 2.2 lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 17/2015 për Metodologjinë e Vlerësimit të Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera, nenin 44 paragrafi 1 të Statutit të Komunës, si dhe bazuar në propozimin shtabit emergjent të komunës dt. 15.06.2023, Kryetari i Komunës merr këtë:

**V E N D I M**  
**PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT TË PËRKOZHSHËM PËR VLERËSIMIN E DËMEVE**  
**NGA VËRSHIMET**

1. Themelohet Komisioni i përkohshëm për vlerësimin e dëmeve nga vërshimet në Komunën e Vushtrrisë, në këtë përbërje:
  - 1.1 **Tefik Maloku**, ing. i bujqësisë – kryesues i komisionit,
  - 1.2 **Fevzi Osmani**, inxhinier anëtar
  - 1.3 **Shemsedin Hyseni**, ingjinier, anëtar
  - 1.4 **Ajet Gërgjaliu**, gjeodet, anëtar
2. Komisioni në përbërje të cekur si në pikën paraprake të këtij vendimi, do të bëjë vlerësimin profesional të dëmeve në bujqësi, ekonomi familjare, biznese etj. në Komunën e Vushtrrisë të shkaktuara nga vërshimet e ditëve të muajit qershor 2023.
3. Komisioni duhet të fillojë me punë menjëherë.
4. Pas përfundimit të vlerësimit komisioni do të hartoj raport për kryetarin e Komunës dhe Qeverinë/Ministrinë përkatëse të Republikës së Kosovës për kompensim të dëmeve.
5. Mandati i komisionit është i përkohshëm – për muajin qershor 2023.
6. Ky komision do të jetë kryej vlerësimit ndaras në terren me komisioni për vlerësim të dëmeve i themeluar me vendimin 02nr. 1661/22, dt. 19.12.2022 i cili ka mandat 4 vjeçar.
7. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



**Ferit Idrizi**  
Kryetar i Komunës

*Ferit Idrizi*

Vendimi ju dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit
- Arkivit të Sekretarisë.



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRN

02 Nr. / Br 742/23

Nr. i fq. / Br. st \_\_\_\_\_

Data: / Datum 16.06.2023

VUSHTRRI - VUÇITRN



REPUBLICA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI  
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 43 paragrafi 14 dhe 44 paragrafi 1 të Statutit të Komunës, dhe rregullores 02/2023 për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës të veprimtarive afariste - bizneseve në Komunën e Vushtrrisë neni 22, Kryetari i Komunës merr këtë:

**V E N D I M**

1. Ju lejohet veprimtarive afariste – bizneseve në Komunën e Vushtrrisë të punohet edhe ditëve të diela nga data 18.06.2023 deri në shfuqizim të këtij vendimi.
2. Ky vendim fillon të zbatohet nga data 18.06.2023.

**Arsyetim**

Duke pasur parasysh situatën e kriuar emergjente që ndodhën se fundi në Komunën e Vushtrrisë si dhe ardhjes së bashkatdhetarëve tanë nga mërgimi, si dhe me kërkesës së bizneseve Kryetari i Komunës merr këtë vendim.

Duka u bazuar në dispozitat e cekura më lartë dhe rrethanave të paraqitura u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.



**Ferit Idrizi**

*Ferit Idrizi*  
Kryetar i Komunës

Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë për Inspektime
- Arkivit të Sekretarisë



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRRI

02 Nr. / Br 750/23

Nr. i fq. / Br. st \_\_\_\_\_

Data: / Datum 21.06.2023

VUSHTRRI - VUÇITRRI



REPUBLICA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 44 paragrafi 1 të Statutit të Komunës, nenit 3 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores(KKV) Nr. 03/2023 për Përcaktimin e Kruitereve të Ndarjes së Mjeteve Financiare nga Fondi si dhe në bazë të propozimit të Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport datë 16 mars 2023, Kryetari i Komunës merr këtë:

### V E N D I M

1. Aprovohet propozimi i Drejtorisë për Arsim për ndarje të mjeteve financiare nga buxheti i Komunës, fondi për transfere dhe subvencione, ndihme financiare me nga 500.00 € (pesëqind euro) për pesë nxënës të Gjinnazit "Eqrem Qabej" në Vushtrri, të shënuar si në vijim:
  - 1.1 Tuana Grabovci
  - 1.2 Gresa Makiqi
  - 1.3 Rizonë Hyseni
  - 1.4 Genta Dervishi
  - 1.5 Finesë Maxhuni
2. Qëllimi i subvencionit sipas pikës paraprake të këtij vendimi është mbulimi i shpenzimeve gjatë qëndrimit në Santa Cruz të Kalifornisë në SHBA ku do të marrin pjesë në programin "Sciencwe Internship (SIP).
3. Pagesa e mjeteve në shumën e cekur në pikën 1. të këtij vendimi të bëhet nga buxheti i Drejtorisë për Arsim – subvencione dhe transfere, në llogarinë bankare të secilës apo përfaqësuesve ligjorë të tyre.
4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtorinë për Arsim.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Ferit Idrizi

Kryetar i Komunës

Vendimi i dërgohet:

- Drejtorisë për Arsim
- Arkivit të Sekretarisë.





REPubLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPËSTINA VUÇITRN

02 Nr. / Br. 752/23

Nr. i fq. / Br. sh. \_\_\_\_\_

Data: / Datum 21.06.2023

VUSHTRRI - VUÇITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Në bazë të nenit 13 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, me 28/04, qershor 2008), si dhe nenit 67 “g” të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

### V E N D I M

1. Lejohet shfrytëzimi i oborreve të shkollave në qytet për parkim pa pagesë të veturave të bashkatdhetarëve tanë të ardhur nga diaspora për pushime të verës, si në vijim:
  - 1.1 SHMU 2
  - 1.2 SHF “Mustafë Venhari”
  - 1.3 SHF “Naim Frashëri”
  - 1.4 SHM “Lutfi Musiqi”
  - 1.5 Ish parkingu i Taxi-ve (përball QK “Hasan Prishtina”).
2. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Arsim në Vushtrri dhe shkollat e cekura në pikën 1 të këtij vendimi si dhe Drejtoria për Shërbime Publike dhe Zyrtari për Informim Publik.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe do të zbatohet nga data 01 korrik deri më 31 gusht 2023.



Ferit Idrizi

Kryetar i Komunës

Vendimi i dërgohet:

- Drejtorisë për Arsim
- Drejtorisë për Shërbime Publike
- Zyrtari për Informim Publik
- Arkivit të Sekretarisë







REPubLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRIË - OPŠTINA VUÇITRË

02 Nr. / Br 762/23

Nr. i fq. / Br. sf \_\_\_\_\_

Data: / Datum 26.06.2023

VUSHTRRI - VUÇITRË



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI  
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenin 44 paragrafi 1 të Statutit të Komunës, si dhe në bazë të kërkesës së Drejtorisë për Administratë dt. 29.06.2023, Kryetari i Komunës, merr këtë:

### V E N D I M

1. Lejohet puna me palë në Drejtorinë për Administratë: Zyrën e gjendjes Civile dhe Qendrën për Shërbim me Qytetarë ditëve të shtuna nga ora 10:00-14:00 gjatë muajit korrik dhe gusht 2023 për shkak të rritjes së fluksit të bashkatdhetarëve të ardhur nga diaspora, në mënyrë që të iu ofrohen shërbime sa më cilësore.
2. Obligohet Drejtoresha për administratë që të i ndërmer të gjitha masat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



**Ferit Idrizi**

*Ferit Idrizi*  
Kryetar i Komunës

Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë për Administratë
- Arkivit të Sekretarisë



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRIŠË-OPŠTINA VUÇITRIN

02 Nr. / Br 769/23

Nr. i fq. / Br. st \_\_\_\_\_

Data: / Datum 29.06.2023

VUSHTRRI - VUÇITRIN



REPUBLICA E KOSOVËS  
KOMUNA VUSHTRRI

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenit 44 paragrafi 1 të Statutit të Komunës, Vendimin e Kuvendit të Komunës 01Nr.231/22 të dt. 29.09.2022, tabela 4.1, si dhe në bazë të Propozimit të Drejtorisë Komunale për Arsim, 10.Nr.545/23 të dt. 23.06.2023, Kryetari i Komunës merr:

V E N D I M

1. znj. Bukuriye Tahiri nga fshati Novolan, Komuna Vushtrri, i lejohen mjete financiare në shumë prej 500 € (pesëqind euro) për mbulimin e shpenzimeve udhëtimit për djalin e saj Granit Tahiri, i cili i vijon aktivitete në kopshtin "Hare dhe Fole" në Vushtrri dhe seanca në klinikën për neorologji "Aura" në Prishtinë pasi që ka kushte të rënda ekonomike e sociale.
2. Shuma e mjeteve të cekura si në pikën paraprake të këtij vendimi duhet të paguhet nga buxheti i Drejtorisë për Arsim – kategoria për subvencione dhe transfere – transporti i nxënësve me nevoja të veçanta.
3. znj. Bukuriye Tahiri apo i autorizuari i saj ligjorë duhet të ofroj kopjen e dokumentit të identifikimit dhe të kartelës bankare në Drejtorinë Komunale për Arsim në Vushtrri me qëllim të implementimit të këtij vendimi.
4. Zbatimin e këtij vendimi do ta bëjë Drejtoria Komunale për Arsim në Vushtrri.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Kryetari i Komunës

*Ferit Idrizi*

Ferit Idrizi

Vendimi ju dërgohet:

- Drejtorisë për Arsim dhe
- Arkivit të Sekretarisë